Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Idriz Cufaj	**24.08.2023**	**03.09.2023**	**2023/0600**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.08.2023, OE " **Arian R. Bytyqi** " - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0600, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: " **Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor** " me nr. të prokurimit: 615-22-11546-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E PODUJEVËS.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedur? t? hapur**, lloji i kontrat?s: **sherbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **183,750.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka proceduar në kundërshtim me:
- Neni 1 – paragrafi 1
- Neni 7 – paragrafi 1,2,3,4,6
- Neni 59 – paragrafi 1,3,4
- Neni 62 – paragrafi 1,2
- Neni 72 – paragrafi 1,2,3

Neni 1 – paragrafi 1 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
Neni 1 - Qëllimi
1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK- Komuna e Podujevës nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 1.
Ne si OE NTSH UNISOFT kemi aplikuar në projektin në fjalë dhe jemi të përgjegjshëm, AK ka kryer shkelje duke mos i përmbushur dhe respektuar detyrimet si autoritet kontraktues sipas nenit 1 të LPP.

Neni 7 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK- Komuna e Podujevës nuk ka trajtuar ne parim RROUP dhe LLP sipas nenit 7.
Ne si OE N.T.SH. UNISOFT me vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit ne jemi të diskriminuar, pasi që jemi OE i cili jemi të përgjegjshëm me çmimin më të ulët dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat të cilat janë në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Neni 59 – paragrafi 1,4 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacion dytësor lidhur me këtë çështje.
2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 59.
Dhe se ne si OE NTSH UNISOFT jemi ofertë e përgjegjshme dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj ne si OE pretendojmë që AK- Komuna e Podujevës nuk ka kryer ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. AK- Komuna e Podujevës dhe komisioni vlerësues janë përgjegjës individualisht për trajtimin e ofertës tonë jo në përputhje me këtë dispozitë.

Neni 62 – paragrafi 1,2 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
1.1 një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.
2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo
2.2 para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK- Komuna e Podujevës nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 62.
Arsye e anulimit të aktiviteti të prokurimit është në kundërshtim me këtë dispozitë pasi nuk plotësohen konditat dhe kushtet që një aktivitet i prokurimit të anulohet sipas LPP-së neni 62. Vendimi mbi anulimin i datës 02.08.2023 është në kundërshtim me dispozitën ligjore të LPP dhe RROUP dhe Vendimin PSH OSHP 2023/0151 dt. 31.05.2023

Neni 72 – paragrafi 1,2,3 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë,

plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK- Komuna e Podujevës nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 72.
Arsye e anulimit të aktiviteti të prokurimit është në kundërshtim me këtë dispozitë pasi nuk plotësohen konditat dhe kushtet që një aktivitet i prokurimit të anulohet sipas LPP-së neni 72. Vendimi mbi anulimin i datës 02.08.2023 është në kundërshtim me dispozitën ligjore të LPP dhe RROUP dhe Vendimin PSH OSHP 2023/0151 dt. 31.05.2023

Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar me dt. 02.08.2023 për OE Arianit R. Bytyqi " B.I. NTSH UNISOFT, Prishtinë si arsyetim i eliminimit është:
1. Mungojnë disa pika nga specifikacioni,
2. Mungon dokumenti ku vërteton të drejtën e pronësisë së materialeve.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne si OE Arianit R. Bytyqi B.I. NTSH UNISOFT, kemi paraqitur argumente të mjaftueshme të cilat janë vërtetuar edhe gjatë prezantimit dhe në sqarimin e kërkuar nga AK se ne si OE i plotësojmë të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit, specifikacionit teknik lidhur me kërkesat të cilat AK ka vendosur. Gjithashtu ne si OE kemi të bashkangjitura edhe liqet për verifikim online të gjitha pretendimeve. Manualet e përdorimit dhe video incizimet. Nëse AK KK Podujeve, nuk ka mundur ta vlerësoj ofertën , apo ka paqartësi rreth pikave të lartpërmendura, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59, pika 2. dhe nenit 72 të LPP-së.
Platforma jonë e-ditari i plotëson të gjitha kërkesat si vijon , pos kërkesave të cilat janë kërkuar nga AK – KK Podujeve, platforma jonë ofron edhe opsione shtesë të cilat janë prezantuar gjatë prezantimit me dt. 17.01.2023.

Platforma i përmbush këto kërkesa nga Aneksi 1:
1. Të jetë platformë elektronike në gjuhen shqipe.
2. Të jetë i përshtatshëm për nxënës dhe mësimdhënës.
3. Njësit mësimore të jen të prezantuara në mënyra elektronike, ku shpjegimi është i shoqëruar me foto dhe video që prezanton në mënyrë praktike njësit mësimore.
4. Njësit mësimore të jen të prezantuara komfor kurrikules dhe plan programit i cili është

duke u aplikuar në vendin ton.
5. Platforma të jetë në dispozicion të mësimdhënësve dhe nxënësve gjate 24 orëve.
6. Kjo platformë të mund të përdoret në shkolle dhe në shtëpi
7. Të përdoret edhe në rast të realizimit të mësimit online.
8. Çdo nxënës te ketë një profil dhe login individual ne programin e vitit shkollor përkatës.
9. Çdo mësues klasor dhe lëndor te ketë qasje ne programet e te gjitha klasave
10. Të beje regjistrimin ne platformën te nxënësve dhe mësuesve, sipas listave emërore te dërguara nga shkollat.
11. Ofroje në platformë, shërbime të tjera plotësuese si mbajtja e shënimeve për mësuesit dhe nxënësit, mbajtja e ditarit, forumi i diskutimit për çdo temë mësimore, mundësinë e listimit te mësimeve për çdo nxënës, si edhe funksionalitete te tjera që do të mundësohen në vazhdim.
12. Venë në dispozicion "video tutorials" për përdorimin teknik të platformës.
13. Venë në dispozicion manualin për aftësimin e mësimdhënësve për përdorimin e platformës online dhe krijimin e mësimeve model për të pasuruar përdorimet e platformës.
14. Riorganizoje dhe plotësoje kurrikulën.
15. Të ofroj një ekip për ndihmë teknike online.
16. Të ofroj manualin për aftësimin e mësimdhënësve për përdorimin e platformës online dhe krijimin e mësimeve model për të pasuruar përdorimet e platformës.
17. Te ofroj shërbime për klasat parafillore e deri në klasën e nëntë ku përfshihen afër 12,500 nxënës dhe 1200 mësimdhënës, ky numër mund të pësoj ndryshime (më shumë apo më pak) në vitet e tjera.
18. Incizimet të jenë origjinale dhe unikate nga operatori që oferton.
19. Për këto karakteristika të ketë të bashkangjitur katalogun.

Ne si OE NTSH UNISOFT, i plotësojmë të gjitha kriteret administrative, teknike dhe profesionale.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, ***janë te njëjta me pretendimet ankimore te parashtruara ne Kerkesen per rishqyrtim te dorezuar te AK.***

KRITERET PËR VLERËSIM

Aneksi 1 Specifikacionet teknike të detyrueshme të dosjes së tenderit

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

B42 - Letër standarde për *[tenderuesin]* e eliminuar [8]

23.06.2023
Komuna e Podujevës
Arianit R. Bytyqi, Prishtinë

Nr. i prokurimit:	615	2	2	1	1	5	4	6	2	1	1

Titulli: Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP "

[Tenderi juaj] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *[dosjen e tenderit]* . Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

[Tenderi i juaj] është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

1. **Mungojnë disa pika nga specifikacioni**
2. **Mungon dokumenti ku vërteton të drejtën e pronësisë së materialeve**

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

Arianit R. Bytyqi Ketij operatori ekonomik i mungojne disa pika nga spesifikacioni: Mungojn dokumenti ku verteton te drejten e pronesis se materialeve.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Arianit R. Bytyqi**

Sqarim hyrës: Për këtë aktivitet te prokurimit ankesa e dorëzuar në OSHP është e përsritur për herë të dytë, ku paraprakishte është trajtuar ankesa dhe është Vendimi i OSHP-së me nr. 2023/0151.
Pretendimi ankimore ka të bëjë me specifikcionet teknike.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi ankimor i OE ankues se është eliminuar pasi që nuk ka plotësuar **Specifikacionet teknike të detyrueshme** te kërkura në dosjen e tenderit si në vijim:

Specifikacioni

Platforma duhet të përmbaj këto karakteristikë:

1. Të jetë platformë elektronike në gjuhen shqipe.
2. Të jetë i përshtatshëm për nxënës dhe mësimdhënës.
3. Njësit mësimore të jen të prezantuara në mënyra elektronike, ku shpjegimi është i shoqëruar me foto dhe video që prezanton në mënyrë praktike njësit mësimore.
4. Njësit mësimore të jen të prezantuara komfor kurrikules dhe plan programit i cili është duke u aplikuar në vendin ton.
5. Platforma të jetë në dispozicion të mësimdhënësve dhe nxënësve gjate 24 orëve.
6. Kjo platformë të mund të përdoret në shkolle dhe në shtëpi
7. Të përdoret edhe në rast të realizimit të mësimit online.
8. Çdo nxënës te ketë një profil dhe login individual ne programin e vitit shkollor përkatës.
9. Çdo mësues klasor dhe lëndor te ketë qasje ne programet e te gjitha klasave
10. Të beje regjistrimin ne platformën te nxënësve dhe mësuesve, sipas listave emërore te dërguara nga shkollat.
11. Ofroje në platformë, shërbime të tjera plotësuese si mbajtja e shënimeve për mësuesit dhe nxënësit, mbajtja e ditarit, forumi i diskutimit për çdo temë mësimore, mundësinë e listimit te mësimeve për çdo nxënës, si edhe funksionalitete te tjera që do të mundësohen në vazhdim.
12. Venë në dispozicion "video tutorials" për përdorimin teknik të platformës.
13. Venë në dispozicion manualin për aftësimin e mësimdhënësve për përdorimin e platformës online dhe krijimin e mësimeve model për të pasuruar përdorimet e platformës.
14. Riorganizoje dhe plotësoje kurrikulën.
15. Të ofroj një ekip për ndihmë teknike online.
16. Të ofroj manualin për aftësimin e mësimdhënësve për përdorimin e platformës online dhe krijimin e mësimeve model për të pasuruar përdorimet e platformës.
17. Te ofroj shërbime për klasat parafillore e deri në klasën e nëntë ku përfshihen afër 12,500 nxënës dhe 1200 mësimdhënës, ky numër mund të pësoj ndryshime (më shumë apo më pak) në vitet e tjera.
18. Incizimet të jenë origjinale dhe unikate nga operatori që oferton.

19. Për këto karakteristika të ketë të bashkangjitur katalogun.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues " Arianit R. Bytyqi " në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertën e tij të dorëzuar me datë 30/11/2022, ka dorëzuar Deklaratë për Specifikikimin Teknike, Deklaratë për pronësi dhe të drejtë Autoriale, Deklaratë për mirëmbajtje dhe garancion, deklaratë për aftësi teknike dhe profesionale (dëshmi për zhvillim dhe prodhim softuer) si në vijim

DEKLARATA PËR SPECIFIKIMIN TEKNIK

Titulli i projektit:	
Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor	
Nr. i Prokurimit	615-22-11546-2-1-1
Nr. i Brendshëm	61522131221

Ky dokument dëshmon se kompania jonë **N.T.SH. "UNISOFT"** në rast se kontrata për projektit e lartcekur i besohet dhe bëhet me kompanin tone. Deklarojmë se specifikimi teknik per shërbimet e ofruara përputhet me Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

N.T.SH. "UNISOFT"

V. V.

Prishtinë, 30.11.2022

DEKLARATA PËR
PRONËSI DHE TË DREJTË AUTORIALE

Titulli i projektit:	
Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor	
Nr. i Prokurimit	615-22-11546-2-1-1
Nr. i Brendshëm	61522131221

Dëshmon se kodet burimore, dizajni i aplikacionit dhe i bazës së të dhënave, autorësia e aplikacionit **e_Ditari** është pronë e kompanisë N.T.SH. UNISOFT dhe se KK Podujeve është duke e shfrytëzuar sistemin sipas marrveshjes.

AK KK Podujevë ka në pronësi të dhënat si: të dhënat e nxënësve, stafit akademik dhe administrativ etj.

N.T.SH. "UNISOFT"

V. V.

Prishtinë, 30.11.2022

DEKLARATË PËR
MIRËMBAJTJE DHE GARANCION

Titulli i projektit:	
Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor	
Nr. i Prokurimit	615-22-11546-2-1-1
Nr. i Brendshëm	61522131221

Ky dokument dëshmon se kompania jonë **N.T.SH. "UNISOFT"** në rast se kontrata për projektit e lartcekur i besohet dhe bëhet me kompanin tone. Ne do të japim garancion për mirëmbajtja për funksionim të softuerit, ku për problemet e paraqitura do të reagojmë sipas kërkesave në DT dhe NJK për riparim të problemeve që paraqiten në sistem.

- **Platforma do të jetë funksional çdo ditë / 24h**
- **Platforma do të ketë mirëmbajtje dhe do të ketë përkrahje nga ne sipas kërkesave ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate.**

Mirëmbajtja do realizohet nga stafi ynë profesional: zhvillues softuerit, teknike, trajner etj.

N.T.SH. "UNISOFT"

V. V.

Prishtinë, 30.11.2022

DEKLARATË

PËR AFTËSI TEKNIKE DHE PROFESIONALE
(DËSHMI PËR ZHVILLIM DHE PRODHIM SOFTUERI)

Titulli i projektit:	
Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor	
Nr. i Prokurimit	615-22-11546-2-1-1
Nr. i Brendshëm	61522131221

Ky dokument dëshmon se kompania jonë **N.T.SH. "UNISOFT"** në rast se kontrata për projektit e lartcekur i besohet dhe bëhet me kompaninë tone., ne si kompani i përmbushim aftësitë teknike dhe profesionale për projektin e lartcekur si: stafi i kualifikuar dhe me përvojë në zhvillimin dhe prodhimin e softuerëve, ambientet e punës, përdorimi i teknologjisë dhe veglave aktuale etj.

Përmes kësaj deklarate dëshmojmë se ne si kompani aktivitet kryesor kemi **zhvillimin dhe prodhimin e softuerit**.

N.T.SH. "UNISOFT"

M. Y.

Prishtinë, 30.11.2022

Sipas Vendimi të OSHP-së i datës 31/05/2023 lënda është kthyer në rivlersim dhe Autoriteti Kontraktues gjatë ri vlerësimit të ofertave me daten 06.07.2023 përmes e-prokurimit ka kërkuar sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik ankues " Arianit R. Bytyqi " duke përdorë formularin B47 Letër Standarde e Kërkesës për sqarimin e tenderit si ne vijim:

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

B47 - Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

Dt. 05.07.2023

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Podujevës

"Arianit R. Bytyqi B.I", Prishtinë

Nr. i prokurimit:	615	22	11	5	4	6	2	1	1

Titulli: "*Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor*"

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Për të rivlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Duke u bazuar në Vendimin e Panelit Shqyrtues (OSHP) me nr.0151/23 që ankesa e OE në fjalë është aprovuar si e bazuar, AK-ja, sipas këti vendimi këtë aktivitet e ka kthyer në Ri-vlerësim për ri-vlerësimin e ofertave në tenderin "Implementimi i platformës digjitale mësimore", ZKA ka caktuar një komision për rivlerësim ndërsa komisioni pas shqyrtimit të ofertave dhe në bazë të vendimit të OSHP-së, kërkojnë nga prokurimi që OE "Arianit R. Bytyqi" të i kërkohën informata gjegjësisht sqarime shtesë sipas Vendimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-së dhe duke u bazuar në Vendimin për ri-vlerësimin e ofertave në tenderin "Implementimi i platformës digjitale mësimore", komisioni pas shqyrtimit të ofertave dhe në bazë të vendimit të OSHP-së, kërkon që të; Rekomandohet OE ankues "Arianit R. Bytyqi B.I" që të vërtetoj të drejtën e pronësisë së materjaleve në platformë.

Autoriteti Kontraktues për të rivlerësuar ofertën e juaj si të përgjegjshme kërkojmë;

1. ***Materialet e platformës dhe***
2. ***Vërtetësin e drejtës së pronësisë për këto materiale.***
3. ***Vlefshmerinë dhe Vazhdimin e sigurimit të ofertës.***

Operatori Ekonomik ankues " Arianit R. Bytyqi " me datën 07.07.2023 përmes e-prokurimit ka ngarkuar sqarimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas kërkesës në letren standarde

Dërguar nga : Arianit R. Bytyqi
Dokumenti për dërgim te AK
E-Prokurimi.pdf 07.07.2023 15:57
Hape: Shqip

Dërguar nga : Arianit R. Bytyqi
Dokumenti për dërgim te AK
UniSoft_Deklarata_Validitetit_SigurmitTenderit.pdf 07.07.2023 15:57
Hape: Shqip

Dërguar nga : Arianit R. Bytyqi
Dokumenti për dërgim te AK
UNISOFT_SigurimiTenderit_PolicaNr115137.pdf 07.07.2023 15:58
Hape: Shqip

Dërguar nga : Arianit R. Bytyqi
Dokumenti për dërgim te AK
UniSoft_DeklarataVertetësinëPronësMateriale.pdf 07.07.2023 15:59
Hape: Shqip

Dërguar nga : Arianit R. Bytyqi
Dokumenti për dërgim te AK
UNISOFT_LinkuPlatformes.pdf 07.07.2023 15:59
Hape: Shqip

Dërguar nga : Arianit R. Bytyqi
Dokumenti për dërgim te AK
UNISOFT_Ballina_eDitari.pdf 07.07.2023 15:59
Hape: Shqip

Dërguar nga : Arianit R. Bytyqi
Dokumenti për dërgim te AK
UNISOFT_Aneksi1_SpecifikacioniTeknik.pdf 07.07.2023 16:00
Hape: Shqip

Dërguar nga : Arianit R. Bytyqi
Dokumenti për dërgim te AK
Shtojca.pdf 07.07.2023 16:01
Hape: Shqip

Dokumentet e kërkuara përmes letrës standarde nga AK, Operatori Ekonomik ankues " Arianit R. Bytyqi " ka dorëzuar materialet e platëformës Shtojca që ka 38 faqe, deklaratën për Vërtetësin drejtës së pronësisë, Aneksi1 SpecifikacioniTeknik i vulosur dhe i nënshkruar, linku i platformës, ballina e ditarit, vlefshmerinë

dhe vazhdimin e sigurimit të ofertës

UniSoft

DEKLARATA

PËR VËRTETËSIN E TË DREJTËS SË PRONËSIS

PËR MATERIALET NË PLATFORMË

Titulli i projektit:	
Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor	
Nr. i Prokurimit	615-22-11546-2-1-1
Nr. i Brendshëm	61522131221

Sipas kërkesës dt. 06.07.2023 përmes platformës së e-prokurimit nga zyra e prokurimit z. Rasim Fejza AK: Komuna e Podujevës.

Tema: Letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, pika 1,2. Materialet e platformës dhe Vërtetësia e të drejtës së pronësisë për këto materiale.

KONFIRMIM:

Ne si OE NTSH UNISOFT (Arianir R. Bytyqi B.I.) konfirmojmë se të gjitha materialet në platformë sipas kërkesës në Aneksin 1 të Specifikacionit Teknik, korrikulës dhe planprogrameve.

1. Materialet e platformës janë pronë e kompanisë NTSH UNISOFT.
2. Të gjitha videot, animacionet dhe materialet tjera të cilat janë për njësitë mësimore dhe tjerat janë me pronësi të kompanisë NTSH UNISOFT.
3. Të gjitha materialet , dhe tjerat janë në harmoni me Ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës për mbrojtjen e të drejtës së autorit.
4. NTSH UNISOFT, i plotëson të gjitha kërkesat në aneksin 1 të DT për Specifikacion Teknik.
5. Mbrojtja e autorësisë dhe veprave intelektuale është e mbrojtur me ligjet në fuqi.

N.T.SH. "UNISOFT"

Prishtinë, 07.07.2023

Adresa : Rr. Raif Pollomi, L1/2, Nr.6 , Prishtinë, Republika e Kosovës
web: www.unisoft-rks.com ; e-mail: info@unisoft-rks.com ; Mob: +383 (0) 44 250 052

UniSoft

Linku i platformës

Titulli i projektit:	
Implementimi i platformës digjitale në procesin mësimor	
Nr. i Prokurimit	615-22-11546-2-1-1
Nr. i Brendshëm	61522131221

https://e-ditari.org

N.T.SH. "UNISOFT"

V. V.

Prishtinë, 30.11.2022

Eksperti shqyrtues pas analizimit të kerkesave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues ne dosjen e tenderit, specifikacionet teknike si dhe ofertën e dorëzuara nga Operatori Ekonomik ankues si dhe sqarimet e kerkuara nga AK dhe deshmit e dorëzuara nga OE ankues, konstaton se OE ankues i plotëson të gjitha kriteret, specifikacionet teknike të kërkuara në dosjen e tenderit dhe është në përputhje të plotë me kerkesat e kërkuara ne dosjen e tenderit.

Duke ju referuar kriterit të sipër permendurë me lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë , mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është **i bazuar.**

Prandaj vlerësoj se Autoriteti Kontraktues nuk ka respketuar në terësi dispozitat e nenit 1, 7 pasi qe OE ankues pretendon se i ploteson të gjitha kriteret e kerkuara duke perfshire edhe specifikacionet teknike te kerkuara. Këtë pretendim e qartëson edhe me shumë sqarimet shtese të dorëzuara sipas kerkëses për sqarime të kërkuara nga AK. Ky pretendim **është i bazuar**.

Autoriteti Kontraktues ka bërë anulimin në kundërshtim me dizpozitat e nenit 62 të LPP-së, pasi qe siaps nenit 62.2.1 të LPP-së, AK mund të përfundojë një aktivitet të prokurimit nëse të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë cmime qe e tejkalojnë buxhetin e Autoritetit Kontraktues gjë e cila në këtë rast nuk ka qenë bazë për anulim. Po ashtu nuk është plotësuar kushti nga neni 44.5 (ii) dhe 46.6 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik për anulim të procedurës së aktivitetit te prokurimit, sipas kësaj Rregullore një tender konsiderohet të jëtë i përgjegjshme në qoftë se përmbush të gjitha kërkesat e në dosjen e tenderit, konsiderohet të jëtë i përgjegjshëm vetëm në oftë se është në përputhje me specifikacionet teknike të prashkruara në dosjen e tenderit dhe në këtë rastë OE ankues është në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara.

Sipas mendimit i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është **i bazuar.**

Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, edhe pse ka kërkuar sqarime shtesë dhe ofertuesi i ka dokumentuar sqarimet e kërkuara pasi që oferta e Operatorit Ekonomik ankues është ofertë e përgjegjshme që i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit si dhe duke përfshire edhe specifikacionet teknike të kërkuara në Aneksin 1. OE ankues është ofertë e përgjegjshme me cmim me të ulët.

Sipas mendimit i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është **i bazuar.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që

ankesa e OE "**Arianit R. Bytyqi "** ankues **të aprovohet e bazuar**, dhe rekomandon **që të anulohet B58 - Njoftimi mbi Vendimin AK**
dhe **që lënda të kthehet në RIVLERËSIM.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PODUJEVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Arianit R. Bytyqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
PRISHTINË/A
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
REPUBLIKA KOSOVA

Idriz Cufaj